



ГРАД СКОПЈЕ - QYTETI I SHKUPIT

Бр. Nr. 08-8996

16. 07. 2025

20

GRAD SKOPJE - SHKUP

Në bazë të Nenit 4 të Rregullores për përcaktimin e mënyrës, kushteve dhe procedurës për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e ngjarjeve, forumeve, festivaleve, manifestimeve, projekte dhe aktiviteteve projektore në fushën e zhvillimit ekonomik lokal nr. 08-10467/1 të datës 25.09.2024, si dhe në lidhje me Programin e aktiviteteve nga fusha e zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit për vitin 2025 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr.16/24), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e "Festivali i birrës"

1. LËNDA

1.1. Lëndë e Thirrjes publike është realizimi i :
"Festivali i birrës"

2. E drejta për pjesëmarrje

2.1. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë të gjitha shoqatat e qytetarëve, fondacionet, federatat, institucionet, shoqëritë tregtare dhe agjencitë e marketingut, të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup, në përputhje me Ligjin për shoqata dhe fondacione dhe Ligjin për shoqëri tregtare, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme të kësaj thirrjeje dhe kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar.

2.2. Përmes thirrjes publike do të ndahen mjete për financimin e manifestimit nga pika 1, nën-pika 1.1, si dhe për zhvillimin, promovimin, mbështetjen dhe përparimin e turizmit, tregtisë dhe gastronomisë, si dhe aktiviteteve të tjera të rëndësishme për qytetin e Shkupit.

3. Korniza kohore dhe mënyra e shpërndarjes së mjeteve

3.1. Mjetet janë siguruar nga Buxheti i qytetit të Shkupit për vitin 2025 në Programin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal të qytetit të Shkupit për vitin 2025 („Gazeta Zyrtare e Qytetit të Shkupit“, nr. 16/24). Shfrytëzimi i mjeteve të ndara do të rregullohet me lidhjen e një Marrëveshjeje mes qytetit të Shkupit dhe aplikantit që plotëson kriteret sipas thirrjes publike.

4. Kushtet kryesore

4.1. Kushtet kryesore që duhet të plotësojnë aplikantët e interesuar që marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- Të jenë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup;
- Të kenë shlyer detyrimet ndaj qytetit të Shkupit (tatimi, taksa komunale); dhe

- Plan marketingu për manifestimin.

8. Mënyra e realizimit të thirrjes publike

8.1. Për përcaktimin e përmbushjes së kushteve themelore dhe kriterëve për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e „Festivalit të Birrës“, Kryetari i Qytetit të Shkupit formon një Komision për realizimin e Thirrjes Publike për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e ngjarjeve dhe manifestimeve në fushën e turizmit, gastronomisë, artizanatit dhe tregtisë, që janë të interesit për qytetin e Shkupit. (Në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

8.2. Aplikimet të cilat nuk janë në kohë, të pasakta (të palexueshme) ose të paplota dhe që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni do t'i refuzojë me një Vendim dhe ato nuk do të shqyrtohen, për të cilat do të informohen aplikantët të cilët kanë dorëzuar aplikime të refuzuara.

8.3. Për aplikimet që janë të plota, në kohë dhe që plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni jep propozim për Kryetarin e Qytetit për zgjedhjen e aplikantit për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e manifestimit.

8.4. Kryetari i Qytetit të Shkupit, sipas propozimit të Komisionit, merr Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e „Festivalit të Birrës“.

9. Afati dhe mënyra e paraqitjes së kërkesave

9.1. Afati për dorëzimin e aplikimeve është 5 ditë nga dita e shpalljes së Thirrjes Publike.

9.2. Kërkesa për me dokumentacion të plotë të dorëzohet në zarf të mbyllur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për zhvillim ekonomik lokal, bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup** (me shënim - Sektori për zhvillim ekonomik lokal - Aplikim për thirrje publike për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e „Festivalit të birrës“)

9.3. Aplikantët e thirrjes publike do të njoftohen për rezultatet brenda 15 ditëve nga data e mbylljes së Thirrjes Publike.

9.4. Dokumentacioni i plotë, aplikimi për mbështetje financiare, përmbajtja, kushtet, kriteret themelore/veçanta (si shtojcë në aplikim) dhe plani financiar për propozimin e projektit janë të disponueshme në ambientet e Qytetit të Shkupit, Sektori për Zhvillimin Ekonomik Lokal, Baraka nr. 6, Zyra nr. 3, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në 16:00 dhe në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk.

9.5. Pyetjet sqaruese mund t'i dërgohen me shkrim ose përmes trajtës elektronike Sektorit për zhvillim ekonomik lokal. Telefoni kontaktues: (02) 3297-284, www.skopje.gov.mk, adresa e e-mail: Biljana.Stojmanovska@skopje.gov.mk.

QYTETI I SHKUPIT